



Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë në Ministri, Komuna
dhe Ndërrmarje Publike
Mars - Qershor 2014



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS



Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë në Ministri, Komuna
dhe Ndërrmarje Publike
Mars - Qershor 2014

Projekti “Mbështetja e politikave kundër-korrupsion duke forcuar mbikëqyrjen publike ndaj shërbimeve publike” mbështet nga:



Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga Open Society Foundation - OSF dhe Civil Rights Defenders - CRD. Qëndrimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë qëndrimet e OSF dhe CRD.

Përmbajtja

Hyrje.....	5
Përmbledhje Ekzekutive	6
Monitorimet me pjesëmarrje direkte të procedurave të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.....	9
Komuna e Prishtinës	10
Komuna e Gjilanit	17
Ministria e Administratës Publike.....	18
Ministria e Drejtësisë.....	21
Shërbimi Korrektues i Kosovës.....	25
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	27
Rekomandime të bazuara në të gjeturat gjatë monitorimit:	29
Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit në këtë periudhë	30
Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit në periudhën mars - qershor	32
Komunat e Kosovës	32
Ministritë e Qeverisë së Kosovës	35
Ndërrmarrjet Publike	39
Falënderime	42
Për Lëvizjen FOL	43

Lista e Shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
CRD	Civil Rights Defenders (Mbrojtësit e të Drejtave Civile)
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
OE	Operator Ekonomik
OSF	Open Society Foundation
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSH	Paneli Shqyrtues (Organ i OSHP-së)
RrPP	Rregullorja e Prokurimit Publik
UOPP	Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
FTD	Fleta e dosjes së tenderit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike

Hyrje

Lëvizja FOL nëpërmjet monitorimit dhe avokimit tashmë për tri vite kontribuon në fushën e Prokurimit Publik. Prokurimi Publik është një ndër instrumentet më të përdorura nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës për shpenzimin e parasë publike dhe si i tillë është një sektor shumë i ekspozuar ndaj keqpërdorimeve dhe korrupsionit. Në këtë kontekst përfshirja dhe angazhimi i Lëvizjes FOL në prokurim publik ka ardhur si rezultat i hulumtimeve paraprake, në të cilat është vërejtur që aferat korruptive dhe keqpërdorimet e parasë publike në nivelin më të lartë ndodhin në faza të ndryshme në prokurimin publik, duke përfshir nivelin qendror dhe atë lokal.

Instrumentet kryesore që FOL ka identifikuar për të monitoruar prokurimin publik në institucione janë ato direkte, me pjesëmarrje dhe indirekte, përmes hulumtimit të institucioneve trupave të prokurimit publik. Gjatë kësaj periudhe, Lëvizja FOL ka publikuar raporte, analiza, tryeza dhe reagime të ndryshme në lidhje me politikat e prokurimit publik.

“Monitoruesi i Prokurimit” është njëra nga mënyrat që FOL synon që të pasqyroj për çdo dy muaj.

Raporti përbëhet nga dy pjesë, në pjesën e parë përshkruhen procedurat e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të cilat FOL i ka monitoruar, ndërsa në pjesën e dytë përshkruhen vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit për periudhën tre mujore. OSHP si organ i pavarur shqyrtues, i cili në bazë të Ligjit për Prokurim Publik 04-L-042 është i autorizuar që të shqyrtoj respektimin e dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Qëllimi i “Monitoruesi i Prokurimit” është që të krijojë një pasqyrë të qartë të problemeve dhe parregullsive që i shoqërojnë procedurat e aktiviteteve të prokurimit.

Në këtë kontekst, Lëvizja Fol me anë të konkluzioneve dhe rekomandimeve synon që të senzibilizoi opinionin publik mbi gjendjen e përgjithshme të respektimit të procedurave dhe dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit publik.

Përmbledhje Ekzekutive

Lëvizja FOL në kuadër të periudhës katër mujore ka monitoruar 12 procedura siç janë: “**Mirëmbajtja dhe rregullimi i fontanave, krojeve dhe monumenteve**”, “**Ndërtimi i rrugës Siqevë - Sharban**”, “**Rregullimi i përroit dhe kanalizimit fekal prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjeve “Arbëria” dhe “Kodra e Trimave”**”, “**Furnizimi me pajisje për kabinete të fizikës, kimisë dhe biologjisë për shkollat fillore dhe të mesme të Prishtinës**” dhe “**Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve - 6 lote**”- të iniciuara nga AK-Komuna Prishtinë, “**Sanimi i rrugëve dhe trotuareve - Mirëmbajtja verore e rrugëve**” i iniciuar nga AK- Komuna Gjilan, “**Punët ndërtimore dhe instaluese në Prokurinë themelore në Pejë - Ri-tenderim**” dhe “**Furnizim me licenca të Microsoft-it**” të iniciuar nga AK-Ministria e Administratës Publike, “**Servisimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë (MD, SHKK, AAPSK)-ri tender**” dhe ri-tenderimin e të njëjtit pasi që është kthyer nga OSHP, i cili ka qenë i ndarë në tri pjesë dhe i iniciuar nga AK - Ministria e Drejtësisë, “**Renovimi i Pavijonit 1 në Q.K. në DUBRAVË**” i iniciuar nga AK- Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe “**Furnizim me derivate për nevoja të MBPZHR-së**” i iniciuar nga AK - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Nga 12 tender, 8 kanë përfunduar me shpallje të fituesit, 3 janë anuluar me rekomandim të komisionit vlerësues për shkak se është pranuar vetëm një ofertë e përgjegjshme, kurse 1 është kthyer në Ri-tenderim me vendim të OSHP-së.

Të gjeturat kryesore nga monitorimet e realizuara nga Lëvizja FOL janë si në vijim: :

- Mos-standardizimi i procesit të hartimit të specifikacioneve dhe kërkesave në *Njoftim për Kontratë*, gjegjësisht në dosjen e tenderit. P.sh në disa institucione publike në rastin e kërkitimit të stafit të kualifikuar pranojnë diploma në nivel Bachelor e disa jo. Një çështje tjetër që është vërejtur tek hartimi i kërkesave dhe specifikacioneve është edhe tenderimi i një numri të madh artikujsh p.sh në një tender me 3 pjesë gjë që ka shkaktuar vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.
- Çmimet jo-normalisht të Ulëta që shpesh janë prezente për artikuj të ndryshëm në ofertën e Operatorëve Ekonomik. P.sh në tender të ndryshëm hasen artikuj që janë ofertuar me çmime jo

reale sic jane 0.01 cent. Lëvizja FOL në mënyrë sistematike ka identifikuar këtë problem, së fundi edhe duke inicuar reagimin në media me datë 8 Maj 2014.

- Mos-koordinimi në mes të institucioneve sic janë p.sh Administrata Tatimore e Kosovës dhe institucioneve tjera publike që tenderojnë shpesh shkakton konfuzion se cili dokument është valid apo për cilën periudhë p.sh në rastet kur kërkohet nga OE dëshmi për pagesën e tatimit të stafit të regjistruar.

Mos-funksionimi i OSHP-së për shkak se anëtarët e bordit të cilëve iu kishte përfunduar mandati, nuk janë zëvendësuar me anëtarë të rinj për një periudhë tetë. mujore. Këtë problematikë, Lëvizja FOL ka vlerësuar se ka dhënë mundësi për keqmenaxhim, keqpërdorim dhe korrupsion në prokurim publik.

Lëvizja FOL, ka mirëpritur emërimin e anëtarëve të rinj të bordit të OSHP-së nga ana e Kuvendit të Kosovës me datë 20 Mars 2014 dhe si rezultat ri-funksionalizimin e këtij institucioni, por nxjerrja e një konkluzioni nga ana e bordit të ri me datë 27 Mars 2014, përmes të cilit ka refuzuar që të shqyrtojë rreth 255 ankesa të deponuara gjatë periudhës kur OSHP ka qenë funksionale me arsyetimin se të njëjtave ju ka skaduar afati ligjor për shqyrtim, ka qenë tejet shqetësuese.

Lëvizja FOL ka vlerësuar se ky veprim ka krijuar:

- Mundësi për keqmenaxhim, keqpërdorim dhe korrupsion në prokurim publik;
- Dëmtim të interesit dhe konkurrencën e drejtë mes operatorëve ekonomik; dhe
- Ka krijuar precedent për raste të tjera ku organet që janë të obliguara me ligj të ndajnë drejtësi të refuzojnë të bëjnë një gjë të tillë;

Në këtë kontekst është dëshmuar poashtu se ky veprim ka krijuar probleme edhe për autoritetet kontraktuese edhe për vetë OSHP-në, e cila është detyruar që në raste të caktuara të kthehet dhe të shqyrtojë raste të cilat kanë qenë të përfshira në këtë konkluzion.

Gjatë periudhës Mars - Qershor, OSHP ka marrë gjithsejt 28 vendime, ku i ka gjetur fajtorë për mos-zbatim të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë procedurave të tenderimit institucione të ndryshme publike sic janë: Komunat, Ministritë dhe Ndërmarrjet Publike.

Nga këto 28 vendime, 17 vendime kanë kthyer tenderët në **Ri-vlerësim**. Së këndejmi, nga 2 tender të iniciuar nga Komuna e Decanit, Ferizajt, Prishtinës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Nga 1 tender i iniciuar nga Komuna e Malishevës, Kamenicës, Gjakovës, Pejës, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Postë - Telekomit i Kosovës janë kthyer në **Ri-vlerësim**.


Përderisa, 8 vendime janë marrë për **Ri-tenderim**. Derisa, nga 1 tender i iniciuar Ministria e Shëndetësisë, e Diasporës, e Punëve të Brendshme, e Drejtësisë, e Infrastrukturës, e Financave, si dhe nga 1 tender i iniciuar nga KEK dhe PTK janë kthyer në **Ri-tenderim**.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me dy vendime të ndara, ka **anulluar** 1 tender të iniciuar nga KEK dhe 1 nga Komuna e Rahovecit, dhe me 1 vendim tjetër ka dënuar me gjobë dhe marrje të certifikatës së zyrtares kryesore të prokurimit në MAPL.

Monitorimet me pjesëmarrje direkte të procedurave të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve

Lëvizja FOL në këtë pjesë të “Monitoruesit të Prokurimit” përshkruan procedurat e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, të cilat i monitoron me pjesëmarrje direkte në bazë të Memorandumeve të Bashkëpunimit që FOL ka realizuar me institucione të ndryshme publike qendrore dhe lokale. Ky monitorim me pjesëmarrje direkte bëhet me qëllim që të monitorohet zbatimi i Ligjit të Prokurimit Publik gjatë procedurave të aktiviteteve të prokurimit dhe të krijohet njëpasqyrë e qartë nga terreni për problemet apo parregullsitë që i shoqërojnë këto procedura.

Në vijim do t'i gjeni të përshkuara 12 procedura të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve në institucione të ndryshme publike qendrore dhe lokale, të cilat Lëvizja FOL i ka realizuar monitorimin me pjesëmarrje direkte. Nga monitorimi 8 nga to kanë përfunduar me shpallje të fituesit, 3 janë anuluar me rekomandim të komisionit vlerësues për shkak se është pranuar vetëm një ofertë e përgjegjshme, kurse 1 është kthyer në Ri-tenderim me vendim të OSHP-së:



Graf. 1. Numri i procedurave të monitoruara nga Lëvizja FOL në institucione të ndryshme publike

Komuna e Prishtinës

Lëvizja FOL ka marrë pjesë në monitorimin e procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Mirëmbajtja dhe rregullimi i i fontanave, krojeve dhe monumenteve”** i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinë , i cili ka qenë tender i llojit Punë dhe kriter i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Poashtu në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë kryetari i komunës. Ndërsa, dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar dhe në bazë të tij komuna i ka pasur të disponueshme 50, 000 euro për këtë tender.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “C4A&Pro Art”- Prishtinë, “Varna Komerce”- Kamenicë dhe “Toifor”- Prishtinë.

Të gjitha ofertat e operatorëve ekonomik janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqitur autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* gjegjësisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tre operatorëve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar se që të tre operatorët ekonomik eE kanë qenë të përgjegjshëm si nga ana administrative edhe nga ana teknike. Mirëpo, OE “Varna Komerce” dhe “TOIFOR” pas llogaritjes së çmimeve për njësi ka rezultuar se kanë pasur gabime aritmetikore, ku çmimi fillestar 48.500,24 euro i OE “Varna Komerce” është ngritur në 48.544,00 euro, kurse çmimi fillestar 44.002,00 euro i OE ”TOIFOR” është ngritur në 44.032,00 euro.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues OE “C4A & ProArt” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë, gjegjësisht me çmim prej 34.480,20 euro. Për dallim çmimi më i shtrenjtë i ofertuar në këtë tender ka qenë 48.544,00 euro.

Me këtë veprim është përfunduar edhe procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe operatori ekonomik i

rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.*

Në këtë tender një e gjetur interesante ka qenë se tek OE “C4A&ProArt” i cili ka qenë konsorcium i bazuar në marrëveshje, lideri i konsorciumit “C4A” e ka pasur të paraqitur në ATK vetëm një punëtor. Duke u bazuar në LPP, meqenëse janë konsorcium, Operatorët Ekonomik e plotësojnë njëri - tjetrin në përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit. Në këtë rast në dosje të tenderit është kërkuar që OE fitues t`i ketë 5 punëtorë të paraqitur në ATK. Konsorciumi e ka përmbushur kushtin ligjërisht, meqenëse partneri tjetër i konsorciumit “ProArt”ka pasur 17 punëtorë të paraqitur në ATK.

Lëvizja FOL ka marrë pjesë në monitorimin e procedurave të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Ndërtimi i rrugës Siqevë-Sharban”** i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **Komuna Prishtinë** , i cili ka qenë tender i llojit Punë ndërsa kriter i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Poashtu në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë kryetari i komunës. Dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar dhe në bazë të tij komuna i ka pasur të disponueshme 810,449.21 euro për këtë tender.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “Clirimi”- Prizren, “Ledi ING & Kastrioti”- Caralevë, “Gashi ING”- Suharekë, “Kag Asphalt”- Prizren, “Gerlica Company”- Ferizaj, “Papenburg & Adriani”- Ferizaj, “Integral & Millenium”- Prishtinë, “Beni Com”- Prishtinë, “Bass Com”- Gjilan, “Eskavatori”- Ferizaj, “Victoria Invest International”- Suharekë, “R & Rukolli”- Skënderaj, “Nëntë Vëllezërit”- Prishtinë, “DKG”- Prishtinë, “Conex Group & Rexha”- Prishtinë, “Jehona”- Malishevë, “Apollonia”- Podujevë, “JahaCompany”- Prishtinë, “Bageri”-Ferizaj.

Të gjitha ofertat e të gjithë operatorëve ekonomik janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* respektivisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë operatorëve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar se përveç 5 operatorëve ekonomik , e të cilët janë: “Kag Asphalt”, “Papenburg & Adriani”, “Beni Com”, “Eskavatori” dhe “R & Rukolli”, të tjerët kanë qenë të papërgjegjshëm, ndonjëri nga ana administrative apo specifikave të gjendjes ekonomike dhe financiare, kurse ndonjëri nga ana teknike.

Kështu, Operatori Ekonomik “Çlirimi” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se kishte paraqitur vetëm një kontratë të punëve paraprake në vlerë 400.000,00 euro, kurse janë kërkuar dy kontrata mbi këtë vlerë, “Ledi ING & Kastrioti” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i ka munguar dëshmia për prodhimin e asfaltit, “Gashi Ing” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i ka munguar Gjeodeti dhe pajisja për punë (finisher), “Gerlica Company” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i ka munguar Gjeodeti, “Integral & Milenium” për shkak të mungesës së bazës së betonit është shpallë i papërgjegjshëm, “Bass Com” është shpallë i papërgjegjshëm në mungesë të kontratave dhe referencave në vlerat e kërkuara njësoj sikurse edhe OE “Victoria Invest International”, “Nëntë Vëllezërit” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i kanë munguar kontratat, dëshmitë për asfalt dhe stafi, “DKG” për shkak se nuk kishte paraqitur dëshmi për prodhimin e betonit, apo marrëveshje me ndonjë prodhues është shpallë i papërgjegjshëm, “Conex Group & Rexha” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka ofruar dëshmi për listën e pajisjeve, poashtu marrëveshja që kishte me kompaninë për furnizim kishte lejen e skaduar, “Jehona” për shkak se ka pasur mungesë të bazës së betonit, gjeodetit dhe sigurimi i tenderit është bërë vetëm për një ditë është shpallë i papërgjegjshëm, “Apollonia” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se ka pasur mungesë të Gjeodeti, kontratave dhe referencave dhe listës së projekteve, “Jaha Company” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak të mungesës së dëshmisë së bazës së betonit, kurse “Bageri” për shkak se nuk ka ofruar dëshmi për kontrata dhe referenca për punë paraprake në vlerat e kërkuar është shpallë i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues operatorin ekonomik “Papenburg & Adriani” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë gjegjësisht me çmim prej 498.967,34 euro. Për dallim oferta e përgjegjshme me çmimin më të shtrenjtë e ofertuar në këtë tender ka qenë 707.091,92 euro.

Me këtë veprim ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe OE i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Ndërkaq, ajo që monitoruesit e FOL kanë gjetur si të dhënë interesante në këtë tender ka qenë kërkesa në dosjen e tenderit që OE ofertues të paraqesin një diplomë për një Gjeodet, mirëpo nuk është specifikuar se a pranohet vetëm me Bachelor apo duhet të jetë Master, e që kjo mandej ka shkaktuar dilema tek komisioni, i cili është dashur të kërkon sqarim.

Procedura e tretë e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - **Komuna Prishtinë** në të cilën FOL ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit gjatë kësaj periudhe është “Rregullimi i përroit dhe kanalizimit fekal prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjeve “Arbëria” dhe “Kodra e Trimave”, i cili ka qenë tender i llojit Punë dhe kriter i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Poashtu në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë kryetari i komunës. Poashtu dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar dhe në bazë të tij komuna i ka pasur të disponueshme 1,230,392.96 euro për këtë tender.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: Alfa I”- Istog, “Ledi Ing & M.Gashi”- Shtime, “DKG & AVE”- Prishtinë, “Beni Com”- Prishtinë, “Shkemi & Valdrini”-Glllogoc, “Jehona”-Malishevë, “Gashi Ing & LG Konstruksion”- Suharekë, “Apolonia”-Podujevë, “Ëienna”- Prishtinë, “Standard & Ak Invest”- Prishtinë, “Toifor & Bini”- Prishtinë, “100% Design” - Skenderaj, “Clirimi”- Prizren, “Euro Project & Doni”- Skënderaj, “Rexha & Mirusha”- Prishtinë.

Të gjitha ofertat e të gjithë operatorve ekonomik, ofertuesit janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë*, respektivisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë operatorëve ekonomik komisioni vlerësues ka konstatuar se përveç 3 operatorve ekonomik, e të cilët janë: “Gashi Ing & LG Konstruksion”, “Alfa I” dhe “Clirimi”, të tjerët kanë qenë të papërgjegjshëm, ndonjëri nga ana administrative apo specifikave të gjendjes ekonomike dhe financiare, derisa ndonjëri nga ana teknike.

Kështu, operatori ekonomik “Ledi Ing & M. Gashi” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk i ka plotësuar kërkesat sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit si në vijim: Referencat për punë të

kryera në 3 vitet e fundit, dëshmia për bazën e betonit dhe ka pasur mungesë të stafit, “DKG & AVE” kështu është shpallë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka ofruar dëshmi për qarkullim bankar për tri vitet e fundit, referencë të punëve paraprake dhe gjeodet të kualifikuar siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

“Beni Com” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i kanë munguar referencat për punët paraprake në tri vitet e fundit dhe dëshmia për prodhimin e betonit.

“Shkambi & Valdrini” për shkak se nuk ka paraqitur kontratë dhe referenca për punët paraprake në tri vitet e fundit, kështu është shpallë i papërgjegjshëm.

“Jehona” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i ka munguar gjeodeti i kualifikuar dhe kontratat për punët paraprake.

“Apolonia” ka qenë e papërgjegjshme për shkak se i kanë munguar kontratat dhe referencat për punët paraprake në tri vitet e fundit, gjeodeti i kualifikuar dhe lista e pajisjeve të punës.

“Eienna” për shkak se i ka munguar kontratat dhe referencat për punët paraprake në tri vitet e fundit, licenca për prodhimin e betonit dhe pajisjet e punës siç janë bageri dhe skipi është shpallë i papërgjegjshëm, “Standard & Ak Invest” ka qenë e papërgjegjshme për shkak se lideri i konsorciumit nuk ka paraqitur deklaratë nën betim, “Toifor & Bini” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i kanë munguar kontratat dhe referencat për tri vitet e fundit si dhe dëshmia për prodhim të betonit.

“100% Design” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i kanë munguar kontratat dhe referencat për punët paraprake në tri vitet e fundit si dhe pajisja Grider.

“Euro Project & Doni” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i kanë munguar kontratat dhe referencat për tri vitet e fundit si dhe stafi i deklaruar si menaxher ka qenë pa kualifikimin e kërkuar.

“Rexha & Mirusha” për shkak se formularin e tenderit e kanë plotësuar gabim dhe paramasa nuk është plotësuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit është shpallë i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues operatorin ekonomik “Gashi Ing & LG Konstruktion”, i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë, respektivisht me çmim prej 603,577.60 euro. Në këtë kontekst oferta e përgjegjshme me

çmimin më të shtrejtë e ofertuar në këtë tender ka qenë 868,163.40 euro.

Me këtë veprim ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe operatori ekonomik i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Në këtë kontekst sikurse edhe në tenderin e përshkruar më lartë, ajo që monitoruesit e FOL kanë gjetur si të dhënë interesante në këtë tender ka qenë kërkesa në dosjen e tenderit që OE ofertues të paraqesin një diplomë për një Gjeodet, mirëpo nuk është specifikuar se a pranohet vetëm me Bachelor apo duhet të jetë Master, e që kjo mandej ka shkaktuar dilema tek komisioni, i cili është dashur të kërkon sqarime shtesë.

Lëvizja FOL ka monitoruar procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Furnizimi me pajisje për kabinate të fizikës, kimisë dhe biologjisë për shkollat fillore dhe të mesme të Prishtinës”** i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës, i cili ka qenë tender i llojit Furnizime dhe kriter i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Poashtu në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë kryetari i komunës. Kësisoj, dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar dhe në bazë të tij komuna i ka pasur të disponueshme 210,000.00 euro për këtë tender.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “Eurolab/Krijon”- Prishtinë, “Abetare”- Rahovec, “Vitech Shpk”- Prishtinë, “N.P - Komed”- Istog dhe “NTT Abacus”.

Të gjitha ofertat e të gjithë operatorve ekonomik, ofertuesit janë vlerësuar edhe nga ana administrative edhe nga ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* respektivisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të pesë OE, komisioni vlerësues ka konstatuar se që të pestët operatorët ekonomik kanë qenë të përgjegjshëm si nga ana administrative edhe ajo teknike.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues operatorin ekonomik “Eurolab/Krijon” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë, gjegjësisht me çmim prej 194.902,22 euro. Kësisoj, ë çmimi më i shtrenjtë i ofertuar në këtë tender ka qenë 314.415,00 euro.

Me këtë veprim ka përfunduar edhe procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe operatori ekonomik i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Lëvizja FOL ka monitoruar procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve - 6 lote”** i iniciuar nga AK- **Komuna Prishtinë**, i cili ka qenë tender i llojit Shërbime dhe kriteri i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parashihet edhe LPP në nenin 58. Kësisoj, në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë kryetari i komunës. Derisa dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar dhe në bazë të tij komuna i ka pasur të disponueshme 90,000.00 euro për këtë tender.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “Mercom Company”- Prishtinë, “Miri”- Prishtinë, “Auto Servis Gëzimi & Hunday”- Prishtinë, “AGS”- Fushë Kosovë dhe “Orio/Vizion”- Prishtinë.

Të gjitha ofertat e operatorëve ekonomik janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqitur autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* gjegjësisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë operatorëve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar se të gjithë operatorët ekonomik E janë të papërgjegjshëm.

Kështu, OE “Mercom Company” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak të mos paraqitjes së tri kontratave për punë të ngjashme dhe distancës që nuk i përshtatej asaj që ishte kërkuar në dosjen e tenderit.

OE “Miri” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak të mos paraqitjes së autorizimit nga prodhuesi, i cili konfirmon se është servis i autorizuar, OE

“Auto Servis Gëzimi & Hunday” është shpallur i papërgjegjshëm për shkak të mos paraqitjes së autorizimit nga prodhuesi dhe një deklaratë të nënshkruar ku do të deklaronte sipërfaqen e parkingut

OE “AGS” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak të mos paraqitjes së autorizimit që dëshmon se është servis i autorizuar dhe OE “Orio/Vizion” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak të mos paraqitjes së tri kontratave për punë të ngjashme dhe CV-ve të punëtorëve.

Duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 4 të LPP-së ku kërkohet që të anulohet aktiviteti i prokurimit në rast të pranimit të më pak se 2 ofertave të përgjegjshme, komisioni vlerësues ka rekomanduar anulimin e këtij tenderi.

Me këtë veprim ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe tenderi është anuluar me *Njoftimin për Anulim*, të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Komuna e Gjilanit

Lëvizja FOL ka audituar dosjen e tenderit të operatorit ekonomik në procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Sanimi i rrugëve dhe trotuareve - Mirëmbajtja verore e rrugëve”** i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, **Komuna e Gjilanit**, i cili ka qenë tender i llojit Punë dhe kriter i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Ndonëse, paraprakisht ka pasur shtyrje të afatit për pranimin e ofertave e cila është bërë konform rregullave përmes një njoftimi të lëshuar nga zyra e prokurimit. Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë kryetari i komunës. Derisa dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “Tali Sh.p.k”- Gjilan, “N.N.P”- Prishtinë, “KNPSH Papenburg & Ardian”- Sojevë, “Bass- Com”- Gjilan, “Elbal Vrbani”- Gjilan, dhe “Conec Group”- Gjilan.

Të gjitha ofertat e operatorëve ekonomik janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* respektivisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë OE, komisioni vlerësues ka konstatuar që të gjithë OE kanë qenë të përgjegjshëm si nga ana administrative e edhe nga ana teknike.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues OE “Tali Sh.p.k” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë gjegjësisht me çmim prej 120,470.00 euro. Për dallim oferta e përgjegjshme me çmimin më të shtrenjtë e ofertuar në këtë tender ka qenë 155,650.00 euro.

Me këtë veprim ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe OE i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Ministria e Administratës Publike

Lëvizja FOL monitoruar në procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit “**Punët ndërtimore dhe instaluese në Prokurinë themelore në Pejë- Ri-tenderim**” i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **Ministria e Administratës Publike** , i cili ka qenë tender i llojit Punë dhe kriter i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Ndërsa, në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë sekretari i përhershëm. Dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar, dhe në bazë të tij ministria i ka pasur të disponueshme 236.048,00 euro për këtë tender. Këtu vlen të theksohet se herën e parë ky tender është anuluar dhe është shpallur në Ri-tenderim për arsye se të gjitha ofertat e kanë kaluar në masë substanciale shumën e mjeteve të disponueshme.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “Mont Komerc”, “Prishtina”, “NNT North”, “Olti Trasing”, “Nbt Ing” dhe “Ceta-Gig & El Mont”.

Të gjitha ofertat e operatorve ekonomikjanë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* respektivisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë operatorëve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar se nga 6 OE ofertues, 4 OE janë të përgjegjshëm, e të cilët janë: “Prishtina”, “Olti trasing”, “Nbt ING” dhe Ceta-GIG & EL Mont”, kurse 2 të tjerët kanë qenë të papërgjegjshëm, ndonjëri nga ana administrative apo specifikave të gjendjes ekonomike dhe financiare kurse ndonjëri nga ana teknike.

Operatori Ekonomik, “Montkomerc” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak të kontratës të cilën e ka paraqitur siç është kërkuar për punë paraprake në lëmin e ndërtimit të lartë në katër vitet e fundit me vlerë minimum sa vlera e ofertës, Ndërsa, nuk iaka bashkangjitur edhe referencën siç është kërkuar.

Operatori Ekonomik “NNT North” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se ka paraqitur plan dinamik me 68 ditë pune duke mos e plotësuar kërkesën që plani dinamik të jetë prej 70 ditë kalendarike.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues OE “Nbt ING” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë respektivisht me çmim prej 199,999.27 euro.

Komisioni vlerësues ka vlerësuar disa çmime të artikujve si jo-normalisht të ulëta, para se të shpallte *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* në pajtim me LPP-në, me letër standarde për informata për tenderë jo-normalisht të ulët i ka kërkuar operatorit ekonomik OE sqarim në lidhje me artikujt. Pas kësaj kërkesë, OE me shkrim ka konfirmuar se tërhiqet nga oferta.

Kësisoj, fitues është shpallur operatori ekonomik i dyti me radhë me çmim më të lirë, i cili është “Prishtina”.

Komisioni, nga ky operatorë ka kërkuar sqarim në lidhje me çmimin e ofruar për disa artikuj, derisa ky i fundit ka konfirmuar me shkrim se është i gatshëm të nënshkruaj kontratën me çmimet e ofruara.

Çmimi ofertues i OE “Prishtina” ka qenë 219,434.00 euro, kurse për dallim oferta e përgjegjshme me çmimin më të shtrenjtë e ofertuar në këtë tender ka qenë 231,887.40 euro.

Me këtë veprim ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe operatori ekonomik i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Ky tender ka qenë një tjetër dëshmi se problemi i çmimeve jo-normalisht të ulëta, i cili nuk është i rregulluar me ligj dhe as me ndonjë akt ligjor sekondar që do të mund të ndërmerre KRPP-ja, po shkakton vazhdimisht probleme në procedurat e tenderëve, por edhe mundësi për manipulim dhe dëmtim të konkurrencës së drejtë. Lëvizja FOL ka shprehur vazhdimisht shqetësimin për këtë, së fundi edhe me reagimin e saj në media me datë 8 Maj 2014.

Në tenderin “**Furnizim me licenca të Microsoft-it**” i iniciuar nga AK-MAP Lëvizja FOL ka monitoruar në procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit, i cili ka qenë tender i llojit Furnizime, ndërsa kriteri i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Ndërsa, në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë sekretari i përhershëm. Dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar me një shumë prej 1,300,000.00 euro për vitin 2104, kurse kjo është një kontratë kornizë për një periudhë 3-vjeçare.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “PBC Kosova” për pjesën e parë, “Cactus” për pjesën e parë dhe të dytë dhe “Next Sense” për pjesën e parë.

Të tre ofertat e OE janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* gjegjësisht dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tre operatorëve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar që të tre OE janë të përgjegjshëm.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për

pjesën e parë si fitues OE “Cactus” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë, respektivisht me çmim prej 2,491,936.09 euro dhe për pjesën e dytë si fitues është rekomanduar OE “PBC Kosova” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë, gjegjësisht me çmim prej 238,844.92 euro. Për dallim, oferta më e shtrenjtë për pjesën e parë ka qenë 2,584,918.78 euro, kurse për pjesën e dytë ka qenë 245,214.31 euro.

Me këtë veprim ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe operatori ekonomik i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Ministria e Drejtësisë

Lëvizja FOL ka audituar dosjen e tenderit të operatorit ekonomik në procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Servisimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë (MD, SHKK, AAPSK)-ri tender”** i cili ka qenë i ndarë në tri pjesë dhe i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **Ministria e Drejtësisë**. Ky tender ka qenë i llojit Shërbime dhe kriteri i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë sekretari i përhershëm. Derisa, dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “NTSH Besi”- për pjesën I, “NTP Bosch”- për pjesën I, “Renault Mucici”- për pjesën II, “NTSH Ford”- për pjesën I dhe II, “NTSH Sfishta”- për pjesën I, II dhe III, “AGS”- për pjesën I, “Miri”- për pjesën I dhe III, “Te Baci”- për pjesën I dhe III, dhe “Eölsäagen” për pjesën I, II dhe III.

Të gjitha ofertat e të gjithë OE ofertues janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë*, gjegjësisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë operatorve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar se për pjesën III të tenderit përveç OE “NTSH Sfishta” që ka qenë i përgjegjshëm, OE ofertues të tjerë kanë qenë të papërgjegjshëm.

“NTP Miri” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se i kanë munguar dëshmitë e kualifikimit të stafit siç janë kërkuar.

“NTSH Ëolfsäagen” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka ofruar dëshmin e kërkuar se ka objekt në Prishtinë.

“Te Baci” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka ofruar dëshmin e kërkuar se ka objekt në Prishtinë dhe ka ndërhy në dosjen e tenderit të përshkrimit të çmimit.

Në këtë kontekst, komisioni vlerësues duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 4 të LPP-së, për shkak se ka pranuar më pak se 2 oferta të përgjegjshme ka kërkuar anulimin e pjesës III të tenderit, e cila më pastaj është anuluar përmes *Njoftimit për Anulim* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Sa i përket pjesës së I -rë, komisioni vlerësues ka konstatuar se oferta të përgjegjshme janë ofertat e OE “NTSH Sfishta”, “NTSH Ford” dhe “NPSH Aqs”. Ndërsa si oferta të papërgjegjshme për shkak të mos plotësimit ose të kushteve administrative ose teknike ka vlerësuar ofertat e OE “NSH Te Baci”, “NTSH Ëolfsäagen”, “NTSH Besi” dhe “NTP Bosch.

Tek pjesa e II-të, komisioni vlerësues duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit ka konstatuar se oferta të përgjegjshme janë të OE “NTSH Sfishta”, “NTSH Fordi” dhe “Renault Mucici”.Ndërsa për shkak të mosplotësimit të kërkesave së dosjes së tenderit si oferta të papërgjegjshme i ka konstatuar ofertat e OE “NTP Miri”dhe “NTSH Ëolfsäagen”.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues për pjesën I-rë dhe të II-të, OE “NTSH Sfishta” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë, respektivisht me çmim prej 77,405.99 euro për pjesën e I-rë dhe 16,974.14 euro për pjesën e II-të. Oferta e përgjegjshme me çmimin më të shtrenjtë e ofertuar në këtë tender për pjesën e I-rë ka qenë 560,388.42 euro dhe për pjesën e II-të ka qenë 25,418.32 euro.

Kësisoj, edhe ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit dhe operatori ekonomik i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Për monitoruesit e Lëvizjes FOL, ky tender ka qenë edhe një dëshmi tjetër për problemin e mos-standardizimit të hartimit të specifikacioneve dhe kërkesave në tender.

Insitucionet e ndryshme publike kanë kërkesa të ndryshme si p.sh tek kontratat me referenca si dëshmi për punët e ngjashme paraprake apo edhe tek dëshmitë për kualifikimin e stafit. Kjo e fundit në këtë tender ka qenë vendimtare që disa operator ekonomik të shpallen të papërgjegjshëm. Tek ky tender problem tjetër ka qenë edhe numri i madh i artikujve të tenderuar, pjesa e I-rë ka pasur 252 derisa pjesa e II-të 325 artikuj. Ndonëse, kriter për dhënie të kontratës ka qenë çmimi më i lirë, atëherë të gjitha këto njësi kanë qenë të vështira të prokurohen me çmim të përgjithshëm. Praktika ka treguar se njësi të caktuara të cilat mund të jenë të panjohura për një zyrtarë prokurimi mund të jenë vendimtare për tenderin që ta përcaktoj atë më të lirë apo më të shtrenjë.

Ashtu si shumë tender të tjerë, edhe këtë tender e ka shoqëruar problemi i çmimeve jo-normalisht të ulëta, kur vërehet se OE ofertues ndër ta edhe ai fitues kanë ofertuar me një sërë artikujsh me çmime jo-normalisht të ulëta.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar nenin 59 paragrafin 2 të LPP-së duke kërkuar sqarime shtesë nga OE fitues, por kjo nuk do të thotë se problemi është sanuar. Prandaj, mund të thekshet që ky rast mbetet problemi më shqetësues i cili kërkon ndërhyrjen e KRPP-së. Autoritetet kontraktuese të kenë çmime referente për artikuj bazik të paktën, në mënyrë që të kenë bazë ligjore për t'i diskualifikuar operatorët ekonomik që ofertojnë me çmime jo-normalisht të ulëta.

Duke u bazuar në të drejtën e tyre të garantuar me LPP, OE “AGS” dhe “NTSH Volksäagen” kanë parashtrua ankesë në OSHP duke pretenduar se në këtë tender AK-MD ka bërë shkelje të disa dispozitave ligjore të LPP-së.

Përshkrim më të detajuar të vendimit të OSHP-së mund të gjeni në pjesën e dytë të këtij raporti ku përshkruhen vendimet e OSHP-së. Megjithatë nga monitorimet e realizuara, është e rëndësishme të vihet në pah se OSHP ka kthyer këtë tender në Ri-tenderim pikërisht për shkak të identifikimi të çmimive që nuk janë çmime të tregut.

Lëvizja FOL pas ri-tenderimit nga ana e AK-MD ka audituar dosjen e tenderit dhe të OE ofertues të tenderit “**Servisimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë (MD, SHKK, AAPSK)-ri tender**” i cili prapë ka qenë i ndarë në tri pjesë. Ky tender ka qenë i llojit, Shërbime dhe kriter i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë sekretari i përhershëm. Derisa, dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “Renault Center Mucici&Europa”- Prishtinë për pjesën e dytë, “N.P.Sh AGS”- Komoran dhe Fushë Kosovë për pjesën e parë, “NTSH Fordi & Rafuna”- Prishtinë për pjesën e parë dhe të dytë.

Të gjitha ofertat e të gjithë operatorëve ekonomik ofertues janë vlerësuar edhe nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* respektivisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë OE, komisioni vlerësues ka konstatuar se për pjesën e parë, oferta të përgjegjshme ka qenë oferta e OE “NTSH AGS”, kurse si ofertë e papërgjegjshme është vlerësuar oferta e OE “Fordi & Rafuna” për shkak se nuk ka plotësuar një sërë kushtesh administrative, teknike e profesionale.

Për pjesën së dytë, ofertat e të dy OE ofertues nuk kanë qenë të përgjegjshme në bazë të komisionit vlerësues. OE “Renault Center Mucici & Europa” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka cekur brandin e gomave që do të ofronte sic është kërkuar në dosjen e tenderit, kurse OE “N.t.sh Fordi & Rafuna” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka paraqitur dëshmi për kapacitetet profesionale dhe dëshmi për çmime, respektivisht CD-së siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Për pjesën e tretë AK-MD nuk kanë pranuar asnjë ofertë.

Komisioni vlerësues duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 4 të LPP-së, për shkak se ka pranuar më pak se 2 oferta të përgjegjshme për secilën pjesë ka rekomanduar që tenderi të anulohet.

Kështu edheka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe tenderi është anuluar me *Njoftimin për Anulim* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Për monitoruesit e Lëvizjes FOL ka qenë shqetësuese ky tender ngaqë është shoqëruar me çmime jo-normalisht të ulëta ose edhe të larta të ofertuara për shërbime të ndryshme nga OE ofertues.

Shërbimi Korrektues i Kosovës

Lëvizja FOL ka monitoruar në procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Renovimi i Pavijonit 1 në Q.K. në DUBRAVË”** i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **Shërbimi Korrektues i Kosovës**, i cili ka qenë tender i llojit Punë dhe kriteri i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë, sekretari i përhershëm. Dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar dhe në bazë të tij SHKK i ka pasur të disponueshme 375,000.00 euro për këtë tender.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: “NBT - ING Sh.p.k & As - ING”- Suharekë, “N.P.N Lindi”- Istog, “NNT Loshi Design & AR Beton”- Istog, “Ceta-Gig Sh.p.k”- Istog, “Shpk Olti Trasing”- Prishtinë, “NNT Art. Konstruksion”- Gjakovë, “NNSH Co-Ing& Infra Plus”- Prishtinë dhe “NN Beni Construction”- Viti.

Të gjitha ofertat e operatorëve ekonomik ofertues janë vlerësuar nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* gjegjësisht në dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të gjithë operatorëve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar se nga 8 operator ekonomik ofertues vetëm 1 gjegjësisht “Shpk Olti Trasing” është i përgjegjshëm, kurse 7 të tjerë kanë qenë të papërgjegjshëm, ndonjëri nga ana administrative apo specifikave të gjendjes ekonomike dhe financiare kurse ndonjëri nga ana teknike.

Operatori ekonomik “Nbt ING Shpk & As ING” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se karshi kërkesës së dosjes së tenderit “Lista e stafit punues që posedon OE minimumi 10 punëtorë prej tyre minimumi një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë dhe një (1) Inxhinier i Arkitekturës (të dëshmohet me dëshmitë e pagesës së tatimit në të ardhura personale në tre mujorin e parë 2014)”. Secili partner i konsorciumit ka paraqitur listën me nga tetë punëtorë, mirëpo nuk ju ka paguar tatimin për tremujorin e parë të vitit 2014, por vetëm për dy mujorin e parë. Operatori ekonomik karshi

kërkesës së dosjes së tenderit që plani dinamik të jetë 150 ditë kalendarike ka paraqitur planin dinamik prej 150 ditë pune.

OE “NPN Lindi” edhe OE “NNT Loshi Design & Ar Beton” dhe “Ceta Gig Shpk”, e kanë pasur mungesën e njëjtë ku tatimin për listën e stafit punues e kanë paguar vetëm për dy mujorin e parë të vitit 2014. Përveç kësaj OE “NPN Lindi” i ka munguar certifikata e TVSH-së dhe plani dinamik ka qenë 120 ditë punë që i ka tejkaluar 150 ditë kalendarik të kërkuara.

OE “Ceta Gig Shpk” i ka munguar dokumenti i kërkuar ku ofron 1 vit garancion për punën e kryer.

OE “NNT Art Konstruksion” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se lista e paraqitur e stafit nuk ka qenë e vulosur dhe ka munguar diploma e inxhinierit të arkitekturës si dhe tatimet nuk kanë qenë të paguara. Poashtu ky karshi kërkesës për 2 kontrata të shoqëruara me referencë për punë të ngjashme OE ka paraqitur vetëm 1 kontratë me referencë dhe nuk ka paraqitur garancion si dhe planin dinamik e ka llogaritur gabim.

OE “NNSH Co-Ing & Infra Plus” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se “Co-ing” si partner konsorciumi listën e stafit të cilëve ua ka paguar tatimin siç është kërkuar nuk ka paraqitur arkitekt.

“Infra Plus” në listën e stafit ka paraqitur arkitekt, por nuk e ka paguar tatimin siç është kërkuar.

OE “Beni-Construction” ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka paraqitur dëshmi se ka paguar tatim në të ardhura personale në ATK për listën e stafit që e ka paraqitur si dhe nuk ka paraqitur një dëshmi nga banka se kompania ka qarkullim financiar prej 700,000.00 euro për vitet 2011, 2012 dhe 2013 siç është kërkuar.

Duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 4 të LPP-së kur kërkohet që “nëse gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit”, kështu komisioni vlerësues ka rekomanduar që ky tender të anulohet.

Me këtë veprim ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe në bazë të rekomandimit të komisionit me *Njoftimin për Anulim* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së është anuluar ky tender për t`u Ri-tenderuar.

Monitoruesit e Lëvizjes FOL në këtë tender kanë ngritur çështjen nëse ka qenë e nevojshme të kërkohet pagesat e tatimit pikërisht për 3 mujorin e

parë të vitit 2014? Ndonëse në Njoftimin për Kontratë është publikuar me datë 10 Mars 2014 dhe duke analizuar se kjo ka qenë arsye që shumica e OE ofertues janë shpallur të papërgjegjshëm, ndoshta edhe pse koha ka qenë e shkurtër që të paguhet tatimi për këtë periudhë. Ky rast ndoshta është një argument që koordinimi në mes të institucioneve të ndryshme në këtë rast ATK dhe SHKK do të ndihmonte zbatimin e Ligjit.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Lëvizja FOL ka monitoruar në procedurën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të tenderit **“Furnizim me derivate për nevoja të MBPZHR-së”** i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**, i cili ka qenë tender i llojit Furnizime dhe kriteri i dhënies së kontratës ka qenë Çmimi më i Ulët.

Hapja e ofertave është bërë në përputhje me afatin e dhënë në dosjen e tenderit ashtu siç parasheh edhe LPP në nenin 58. Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit është formuar me vendim të nënshkruar nga personi përgjegjës e që në këtë rast ka qenë sekretari i përhershëm. Dokumenti mbi disponueshmërinë e mjeteve financiare ka qenë i nënshkruar për një shumë fillestare, ndonëse kjo është një kontratë kornizë për një periudhë 3-vjeçare.

Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar në këtë tender janë: **“HIB Petrol”**- Ferizaj dhe **“AL Petrol”**- Fushë Kosovë.

Të dy ofertat e OE ofertues janë vlerësuar nga ana administrative dhe ajo teknike në bazë të kërkesave që i ka paraqit autoriteti kontraktues në *Njoftimin për Kontratë* gjegjësisht dosjen e tenderit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e të dy operatorëve ekonomik, komisioni vlerësues ka konstatuar se **“Hib Petrol”** është i përgjegjshëm në të dy pjesët, kurse **“Al Petrol”** është i papërgjegjshëm për të dy pjesët.

OE **“AL Petrol”** ka qenë i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka paraqitur certifikatën ekualifikueshmërisë për ISO 9001 dhe deklaratën me shkrim ku do të garantonte dëmshpërblimin në rast se vërtetohet se automjetet e ministrisë janë dëmtuar nga derivatet.

Duke u bazuar në nenin 60 të LPP dhe kriterin për dhënien e kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit, komisioni vlerësues ka rekomanduar për fitues OE “HIB Petrol” i cili ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme me çmim më të lirë gjegjësisht me çmim prej 0.19 euro për njësi për pjesën e parë dhe 13,765.00 euro për pjesën e dytë.

Në këtë tender, vlen të vihet në pah se tenderi është ri-shpallur 3 herë radhazi nga ana e AK-së. Siç shihet edhe për të tretën herë nuk ka pasur 2 oferta të përgjegjshme të operatorët ekonomik. Mirëpo për shkak se kontrata bazë i kishte përfunduar AK-së që nga muaji Mars, kurse tenderi është ri-shpallur për të tretën herë me datë 12.05.2014 kur ishte në përfundim e sipër edhe Aneks kontrataPrandaj, AK me kërkesë duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 5 të LPP-së për revokim të kërkesës që të jenë të paktën 2 OE të përgjegjshëm, ka shpallur fituesin edhe pse ka pasur vetëm një OE ofetues të përgjegjshëm.

Kësisoj edhe ka përfunduar procedura e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, dhe OE i rekomanduar është shpallë fitues edhe me *Njoftimin për Dhënie të Kontratës* të publikuar në ueb-faqe të KRPP-së.

Rekomandime të bazuara në të gjeturat gjatë monitorimit:

- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të inicioj standardizimin e specifikacioneve dhe kërkesave administrative dhe teknike në *Njoftimin për Kontratë* gjegjësisht në dosjen të tenderit në konsultim me Autoritetet Kontraktuese dhe pas vlerësimit kërkesa dhe specifikacione mund të jenë standarde për të gjitha institucionet;
- KRPP në bashkëpunim me Agjencionin e Konkurrencës të inicioj hartimin e listës me çmime referente të paktën për artikujt bazik në mënyrë që të ndihmojë në parandalimin e problemeve me çmime jo-normalishtë të ulëta.
- Të promovohet koordinimi në mes të institucioneve të ndryshme siç është p.sh ATK dhe institucioneve publike që iniciojnë tender, në mënyrë që mos të krijohet konfuzion se cilat dokumenta ose kërkesa janë valide për sa i përket dokumenteve që lëshojnë institucionet e tilla siç është ATK;

Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit në këtë periudhë

Lëvizja FOL në këtë pjesë të “Monitoruesit të Prokurimit” monitoron dhe prezanton vendimet e marra nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, i cili është institucion që në bazë të Ligjit për Prokurim Publik ka kompetencat dhe përgjegjësit për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve të ankesave për sa i përket procedurave të prokurimit publik.

Mos-funksionimi i OSHP-së për shkak se anëtarët e bordit të cilëve ju kishte përfunduar mandati nuk janë zëvendësuar me anëtarë të rinj për një periudhë gati tetë (8) mujore ka qenë tejet shqetësues. Lëvizja Fol ka vlerësuar dhe ka inicuar reagime për shkak se kjo situatë e krijuar ka dhënë mundësinë për keqmenaxhim, keqpërdorim dhe korrupsion në prokurim publik. Andaj, Lëvizja Fol ka mirëpritur emërimin e anëtarëve të rinj të bordit të OSHP-së nga ana e Kuvendit të Kosovës me datë 20 Mars 2014. Ndonëse, nxjerrja e një konkluzioni nga e bordit të ri me datë 27 Mars 2014, përmes të cilit ka refuzuar që të shrytojë rreth 255 ankesa të deponuara gjatë periudhës kur OSHP nuk ka qenë funksionale me arsyetimin se të njëjtave iu ka skaduar afati ligjor për shqyrtim, gjë e cila vazhdon të jetë shqetësuese.

Lëvizja Fol ka vlerësuar se ky veprim ka krijuar:

- Mundësi për keqmenaxhim, keqpërdorim dhe korrupsion në prokurim publik;
- Dëmtim të interesit dhe konkurrencën e drejtë mes operatorëve ekonomik; dhe
- Ka krijuar precedent për raste të tjera ku organet që janë të obliguara me ligj të ndajnë drejtësi të refuzojnë të bëjnë një gjë të tillë;


Kësisoj, ky veprim ka krijuar probleme edhe për autoritetet kontraktuese, por edhe për vetë OSHP-në, e cila është detyruar që në raste të caktuara të kthehet dhe të shqyrtojë raste të cilat kanë qenë të përfshira në këtë konkluzion.

Gjatë periudhës Mars - Qershor, OSHP ka marrë gjithsejt 28 vendime, ku i ka gjetur fajtores për mos-zbatim të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë procedurave të tenderimit institucione të ndryshme publike siç janë: Komunat, Ministrinë dhe Ndërmarrjet Publike.

Nga këto 28 vendime, 17 vendime kanë kthyer tenderët në **Ri-vlerësim**. Nga 2 tender të iniciuar nga Komuna e Deçanit, Ferizajt, Prishtinës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga 1 tender i iniciuar nga Komuna e Malishevës, Kamenicës, Gjakovës, Pejës. Ministria e Administratës Publike, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Postë- Telekomit i Kosovës janë kthyer në **Ri-vlerësim**.

Derisa, 8 vendime janë marrë për **Ri-tenderim**. Nga 1 tender i iniciuar Ministria e Shëndetësisë, e Diasporës, e Punëve të Brendshme, e Drejtësisë, e Infrastrukturës, e Financave, si dhe nga 1 tender i iniciuar nga KEK dhe PTK janë kthyer në **Ri-tenderim**.

OSHP me dy vendime të ndara ka anuluar 1 tender të iniciuar nga KEK dhe 1 nga Komuna e Rahovecit, dhe me 1 vendim tjetër ka dënuar me gjobë dhe marrje të certifikatës së zyrtares kryesore të prokurimit në MAPL.



Graf. 2. Numri i vendimeve të OSHP-së për institucione të ndryshme publike

Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit në periudhën mars - qershor

Në vijim mund t`i gjeni vendimet e OSHP-së përgjatë periudhës Mars - Qershor 2014:

Komunat e Kosovës

Operatorët ekonomik “LIKA Trade Shpk”ka parashtuar ankesë në OSHP, në të cilën ka pretenduar se AK- **Komuna e Deçanit** ka shkelur nenin 62 të LPP-së, me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit “**Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në tëerritorin e komunës së Deçanit**”. Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP, pas shqyrtimit të lëndës ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe AK dhe të ri-vlerësoj tenderin. Meqenëse, OE ankues dhe AK janë pajtuar me këtë rekomandim, Paneli Shqyrtues ka vendosur që tenderi të ri-vlerësohet.

Në aktivitetin tjetër të prokurimit“**Furnizim me material administrativ për KK e Deçanit, Shkolla dhe QKMF- Adem Ukëhaxhaj në Deçan**” të inicuar nga AK- **Komuna Deçan**, OE “AGIMI-DE” ka parashtuar ankesë në OSHP, në të cilën ka pretenduar se AK- **Komuna Deçan** ka shkelur nenin 6, 7 dhe 59 të LPP-së me rastin e dhënies së kontratës. Me këtë rast eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP, pas shqyrtimit të lëndës ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe AK të ri-vlerësoj tenderin. OE ankues nuk ka njoftuar nëse pajtohet me këtë rekomandim, por meqenëse AK është pajtuar, Paneli Shqyrtues ka vendosur që tenderi të ri-vlerësohet.

Operatori ekonomik “Standard Plus” ka deponuar ankesë në OSHP kundër njoftimit për dhënie të kontratës në lidhje me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i objektit të shkollës në fshatin Guriq**”, duke pretenduar se në këtë rast AK- **Komuna e Malishevës** ka bërë shkelje të neneve 7 dhe 59 të LPP-së. Paneli Shqyrtues i OSHP-së pas trajtimit të të gjitha provave dhe dëgjimit të të gjitha palëve në seancën dëgjimore, ka konstatuar se AK nuk ka respektuar nenet 59, 60 të LPP-së dhe nenin 9 të Rregullores për Prokurim Publik. Prandaj ka urdhëruar AK-Komuna e Malishevës që tenderin në fjalë ta kthejë në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik “Rojet e Nderit Shpk” dhe OE “Skyfterat Live” kanë deponuar ankesë në OSHP kundër njoftimit për dhënie të kontratës për tenderin **“Sigurimi fizik i objekteve të Komunës dhe objekteve tjera të cilat funksionojnë në kuadër të Komunës”** të iniciuar nga AK- **Komuna Ferizaj**, në të cilën kanë pretenduar se AK ka bërë shkelje të neneve 7,8, 9, 10, 27, 28, 29, 38, 51, 59 dhe 67.2 të LPP-së. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe dëgjimit të të gjitha palëve në seancë dëgjimore ka konstatuar se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së. Prandaj ankesën e OE ankues e ka aprovuar si të bazuar dhe ka urdhëruar AK që tenderin ta kthejë në **Ri-vlerësim**.

Në tenderin **“Furnizimi i fermerëve me zgjoje(sandëk) të bletëve”** OE “Omad”- Ferizaj ka parashtruar ankesë duke pretenduar se **AK-KK Ferizaj** ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 7 të LPP-së dhe nenit 35.3 të Udhëzuesit Operativ për prokurim publik. Paneli Shqyrtues pasi që ka trajtuar të gjitha provat dhe ka dëgjuar palët në seancën për shqyrtim kryesor, ka konstatuar se autoriteti kontraktues - **KK Ferizaj** nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, ndonëse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka qenë i përgjegjshëm dhe nenin 7 duke mos i trajtuar njëjtë ofertuesit. Prandaj PSH këtë tender të **KK Ferizaj** e ka kthyer në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik “NSH Geo Map” ka deponuar ankesë në OSHP kundër njoftimit për dhënie të kontratës për tenderin **“Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore”** të iniciuar nga AK- **Komuna e Kamenicës**, në të cilën ka pretenduar se me këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të të gjitha provave ka konstatuar se AK nuk ka respektuar nenet 7, 59 dhe 65 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, dhe OE ankues është i papërgjegjshëm meqë nuk ka plotësuar disa nga kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Prandaj e ka aprovuar ankesën si pjesërisht të bazuar dhe ka urdhëruar AK që tenderin ta kthejë në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik “NTSH Ideal Project” ka deponuar ankesë në OSHP kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit **“Mbikqyrja profesionale e projekteve- punëve gjatë realizimit”** të iniciuar nga AK- **Komuna e Gjakovës**, në të cilën ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të neneve 59 dhe 62 të LPP-së. Eksperti shqyrtues në raportin e tij ka konstatuar se AK ka bërë shkelje të neneve 59, 61, 62 të LPP-së si dhe nenit 32.8 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, me ç’rast ka rekomanduar Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**. Meqenëse edhe OE ankues edhe AK janë pajtuar me këtë raport, Paneli Shqyrtues ka përfunduar

procedurën e ankesës në këtë fazë dhe ka urdhëruar në përfundim që tenderi të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Në rastin e aktivitetit të prokurimit apo tenderit **“Sanimi i gropave nëpër qytetin e Prishtinës për vitin 2014”** OSHP ka marrë në shqyrtim lëndën pasi që OE “**Ëiena**”- Obiliq ka deponuar ankesë me pretendimin se **KK e Prishtinës** ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së. PSH pasi ka trajtuar të gjitha provat dhe ka dëgjuar palët në seancën për shqyrtim kryesor ka konstatuar se autoriteti kontraktues - **KK Prishtinë** nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së meqenëse ka rekomanduar për kontratë OE, i cili nuk e ka plotësuar formularin e të dhënave të tenderit- përkatësisht validitetin e ofertës, dhe nenin 60 duke qenë se kriter për dhënien e tenderit ka qenë çmimi më i ulët kurse **AK-KK Prishtinë** ka rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm. Prandaj PSH këtë tender të **KK Prishtinë** e ka kthyer në **Ri-Vlerësim**.

Në tenderin **“Zgjerimi i ndriçimit publik në Prishtinë për vitin 2014”** OE “**Electra**” ka parashtruar ankesë duke pretenduar se **AK-KK Prishtinë** ka bërë shkelje të një sërë dispozitash ligjore me rastin e rekomandimit për kontratë të OE “**Eltris**”. Paneli Shqyrtues pasi që ka trajtuar të gjitha provat dhe ka dëgjuar palët në seancën për shqyrtim kryesor ka konstatuar se autoriteti kontraktues - **KK Prishtinë** nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së. meqenëse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar mundësitë teknike dhe profesionale gjegjësisht pikën ku shkruhet *“numri mesatar i punëtorëve të paraqitur në ATK, gjatë vitit 2011, 2012 dhe 2013 minimum pesë(5)”*. Në këtë kontekst, PSH këtë tender të **KK Prishtinë** e ka kthyer në **Ri-vlerësim**.

Në tenderin **“Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Loxhë”** OE “**Engineering Group**”-Deçan ka parashtruar ankesë duke pretenduar se **AK-KK Pejë** ka bërë shkelje të një sërë dispozitash ligjore me rastin e rekomandimit për kontratë të OE “**NNTSH Drini Company & NTPN Krasniqi**”. Paneli Shqyrtues pasi që ka trajtuar të gjitha provat dhe ka dëgjuar palët në seancën për shqyrtim kryesor ka konstatuar se autoriteti kontraktues - **KK Pejë** nuk ka respektuar nenin 7 dhe 59 të LPP-së. Prandaj PSH këtë tender të **KK Pejë** e ka kthyer në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik **“NNT Am-Com”** ka parashtruar ankesë në OSHP në lidhje me tenderin **“Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të komunës së Rahovecit”** duke pretenduar se **AK-Komuna e Rahovecit** në këtë rast ka bërë shkelje të nenit 5 të LPP-së. Eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP në raportin e tij ka konstatuar se ankesa është e qëndrueshme dhe ka rekomanduar që tenderi të **anulohet**. Meqë edhe OE ankues edhe **AK** janë pajtuar me këtë raport, procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë.

Ministritë e Qeverisë së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesë nga OE “SINORG Pharmaceuticals” kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me produkte farmaceutike nga L.E. Lot-87”- të iniciuar nga AK- **Ministria e Shëndetësisë**, në të cilën OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të neneve 54 dhe 60 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik të autorizuar nga OSHP në raportin e ekspertizës kanë konstatuar se AK gjatë procesit të vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, në përgjithësi ka respektuar nenin 59 të LPP-së, meqenëse i ka kaluar periodha e vlefshmërisë së ofertës së operatorit ekonomik ankues, kanë rekomanduar panelit shqyrtues që të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës dhe të urdhërohet AK-ja që këtë aktivitet të prokurimit ta kthej në **ri-tenderim** nëse edhe më tutje ka interes. Derisa ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar. AK është pajtuar me këtë raport, kurse OE ankues ka pasur qëndrim të kundërt. Paneli Shqyrtues duke e marrë parasysh edhe faktin se lënda është e përfshirë në konkluzionin e 24 Marsit 2014 ka aprovuar mendimin e ekspertëve shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar si ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës nga OE “Dita” për aktivitetin e prokurimit “**Shërbime Transporti**” të iniciuar nga AK- **Ministria e Diasporës**, në të cilën OE ankues ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të neneve 7, 10, 27, 59 dhe 69 të LPP-së. Eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP në raportin e tij ka konstatuar se pretendimet e OE ankues janë të qëndrueshme dhe ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe tenderi të kthehet në Ri-tenderim. Meqenëse, AK- **Ministria e Diasporës** është pajtuar me këtë raport, procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë dhe AK është urdhëruar që lëndën ta kthejë në **Ri-tenderim**.

Operatori ekonomik “Sigma Vienna Insurance Group” Sh.A- Dega Kosovë ka parashtruar ankesë në OSHP kundër njoftimit për dhënie të kontratës për tenderin “**Sigurimi i Ndërtesave Qeveritare**” të iniciuar nga AK- **Ministria e Administratës Publike**, në të cilën ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të neneve 7 dhe 59 të LPP-së. Eksperti shqyrtues në raportin e tij ka konstatuar se AK nuk i ka respektuar këto dy nene gjatë procedurave të tenderit në fjalë dhe ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe tenderi të kthehet në Ri-vlerësim. Meqenëse edhe OE ankues edhe AK janë pajtuar me këtë raport, Paneli Shqyrtues ka përfunduar procedurën e ankesës në këtë fazë dhe ka urdhëruar AK që tenderi të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik "BOTEK Shpk"- Prishtinë ka parashtruar ankesë në OSHP, në të cilën ka pretenduar se **AK- Ministria e Punëve të Brendshme** ka bërë shkelje të nenit 28 pika 2, 7 dhe 8 të LPP-së duke përpiluar specifikime teknike favorizuese ndaj një produkti të caktuar në tenderin "**Krijimi i arkives elektronike, Furnizim me harduer, kamera, softuer dhe mirëmbajtja e tyre**". Me këtë rast, eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP, pas shqyrtimit të lëndës ka rekomanduar që ankesa të aprovohet dhe lënda të kthehet në ritenderim, meqenëse AK-MPB ka bërë shkelje të nenit 7 duke favorizuar një produkt. Pas seancës dëgjimore, paneli shqyrtues ka konstatuar se AK-MPB ka bërë shkelje të neni 7 dhe 28 të LPP-së dhe ka urdhëruar AK që në bazë të rekomandimit të ekspertit shqyrtues tenderin të kthehet në **Ri-tenderim**.

Operatori ekonomik "ALLMAKES GLOBAL SERVICES" si dhe OE "N.T.SH VOLKSÄAGEN" kanë parashtruar ankesë në OSHP lidhur me tenderin "**Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në Ministrinë e Drejtësisë**", të inicuar nga **Ministria e Drejtësisë**. OE "AGS" ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, ndërkaq OE "N.T.SH Volksäagen" ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 1 dhe 2, nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së, si dhe ka bërë shkelje të neneve 35 dhe 41 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik. Ekspertët shqyrtues të autorizuar nga OSHP pas shqyrtimit të lëndës në raportin e ekspertizës kanë konstatuar se nuk qëndrojnë pretendimet e OE ankues "AGS" dhe kanë rekomanduar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e OE ankues. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues "Volksäagen", ata kanë vlerësuar se qëndrojnë, për faktin se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së, nenin 35.5 dhe 35.10 të UOPP-së, duke e shpallur të papërgjegjshëm OE ankues "Volksäagen", sepse i njëjti ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit pika 5 paragrafi 1, sepse nuk është kërkuar që vendi i kryerjes së shërbimeve (servis) të jetë në Prishtinë, ashtu siç pretendon AK në arsyetimin e eliminimit të OE në fjalë. Eksperti shqyrtues ka rekomanduar që lënda të kthehet në ri-vlerësim. Meqenëse me këtë raport nuk janë pajtuar AK dhe OE ankues, PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe pasi ka trajtuar të gjitha provat ka konstatuar se AK-MD nuk kanë respektuar nenin 59 të LPP-së dhe se ankesat e OE ankues janë pjesërisht të bazuara. Meqenëse çmimet e ofruara nga OE ofertues në këtë tender nuk janë çmime të tregut, PSH vendosi që tenderi të kthehet në **Ri-tenderim**.

Operatori ekonomik "NTP Bajraktari COM" ka deponuar ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE "Edukimi" duke pretenduar se **AK - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë** ka bërë shkelje të nenit

42, 52, 56 dhe 59 të LPP lidhur me tenderin **“Furnizim me ushqim, material higjienik në Qendrat Burimore”**. Eksperti Shqyrtues gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka konstatuar se AK nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP. Prandaj vlerëson se ky lëshim nuk ka ndikuar në rezultatin final për këtë aktivitet të prokurimit. Në anën tjetër Paneli Shqyrtues pas seancës dëgjimore në të cilin ka shqyrtuar të gjitha faktet dhe dëgjuar të gjitha palët, ka konstatuar se AK ka bërë shkelje të nenit 59 paragrafi 3 të LPP-së dhe ka urdhëruar që ky tender të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Tenderi **“Shërbime hoteliere për nevoja të MASHT-it”** të iniciuar nga **AK-MASHT**, OE **“Dph LUZERN”**- Prishtinë ka deponuar ankesë kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit duke pretenduar se **AK-MASHT** nuk ka respektuar nenet 7, 10, 54, 52, 60 dhe 62 të LPP-së. Eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP në raportin e tij ka konstatuar se ankesa është e qëndrueshme dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**. Meqenëse, edhe OE ankues edhe **AK-MASHT** janë pajtuar me këtë raport, procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë.

Operatori ekonomik **“NTGI Grafo Loni”** ka deponuar ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit **“Shërbimet e dizajnit dhe shtypja e materialeve të ndryshme”**, të iniciuar nga **AK - Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë**. OE ankues ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP, respektivisht nenit 6, 7, 59 dhe 60, si dhe neni 24 i Rregullores së PP. PSH pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe dëgjimit të të gjitha palëve në seancë dëgjimore duke përfshirë edhe ekspertin shqyrtues me raportin e të cilit nuk ishin pajtuar palët ka konstatuar se ka shkelje të nenit 59 paragrafi 3 dhe 60 paragrafi 1 pika 1 të LPP-së, dhe si rezultat ka urdhëruar që tenderi të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik **“SHPK VB TOFA.J & SHPK .JOOS KRASNIQI”** - Junik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE **“SALLAHU”**- Kaçanik në tenderin **“Ndërtimi i rrugës Junik-Xheravicë (faza e dytë, punët tokësore)”**, duke pretenduar se **AK Ministria e Infrastrukturës** ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së. Eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP për shqyrtimin e lëndës në raportin e tij ka konstatuar se **AK-MI** ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**. PSH në seancën dëgjimore pasi që ka trajtuar të gjitha faktet si dhe dëgjuar të gjitha palët ka konstatuar se ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar sepse AK ka shkelur nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe ka urdhëruar që tenderi të kthehet në **Ri-tenderim**.

Operatori ekonomik "N.T.SH.Allmakes Global Services" si dhe OE "N.T.SH. Europa & N.SH Te Baci" si palë ankuese kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE "'Besi & Gerguri" për Lot 1 dhe OE "Auto Kaqandolli" Prishtinë për Lot 2, për aktivitetin e prokurimit "**Servisimi, mirëmbajtja dhe furnizimi me pjesë rezervë e veturave të MPMS-së rishpallje 2" Lot 1 dhe Lot 2.** OE ankues "N.T.SH.Allmakes Global Services" pretendon se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së. Operatori tjetër Ekonomik "N.T.SH. "Europa & N.SH Te Baci" ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të nenit 52 dhe 54 të LPP-së. Eksperti shqyrtues ka konstatuar së qëndron pretendimi i të dy OE ankues, dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim. PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe ka trajtuar të gjitha provat ka konstatuar se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Operatori ekonomik "BOTEK SHPK" si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE "PBC&KOSOVA" lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Integrimi i sistemeve softuerike (zhvillimi i dataëarehouse) dhe implementimi i sistemit raportues**". OE pretendon se **AK- Ministria e Financave** ka bërë shkelje në nenet 7, 28, 34, 59, 69, 72, të LPP, si dhe nenin 29 të Udhëzuesit Operativ për PP. Ekspertët shqyrtues në raportin e tyre e kanë cilësuar këtë ankesë si të pabazuar. Mirëpo meqë OE ankues nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore, ku pasi i ka shoshitur të gjitha faktet si dhe ka dëgjuar të gjitha palët, ka konstatuar se është bërë shkelje e neneve 56 dhe 59 të LPP-së dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-tenderim.**

Operatori ekonomik "Project Plus"sh.p.k- Prishtinë ka parashtruar ankesë në OSHP kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE "Prima Injineriing ntp & Studio Rebus"Prishtinë - Tiranë në lidhje me tenderin "**Hartimi i projektit ideor dhe zbatues për objekti e palestrës sportive në komunën e Vitisë**" të iniciuar nga **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.** Eksperti Shqyrtues i autorizuar nga OSHP, në raportin e tij ka konstatuar se AK-MKRS gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar nenin 7 dhe 59 të LPP-së duke qenë se ka shpërblyer me kontratë OE që nuk i ka plotësuar kriteret e dosjes së tenderit dhe ka rekomanduar që tenderi të kthehet në **Ri-vlerësim.** Meqenëse edhe OE ankues edhe AK-MKRS janë pajtuar me këtë raport, procesi i ankesës ka përfunduar në këtë fazë.

Ndërrmarrjet Publike

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesë nga OE “Turbo Care” nga Polonia, në lidhje me aktivitetin e prokurimit “**Riparimi kapital i turbinës me avull dhe gjeneratorit elektrik njësia A4 dhe A5- TC Kosova A**”, në të cilën OE ankues pretendon se AK- KEK ka bërë shkelje të neneve 7, 30, 65, 69, 59 dhe 60 të LPP-së me rastin e dhënies së kontratës një OE tjetër. Paneli Shqyrtues i OSHP-së, duke u bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues dhe pasi ka ndëgjuar të gjitha palët në seancën dëgjimore ka konstatuar se AK-KEK nuk kanë respektuar nenin 13, 59 dhe 69 të LPP-së. Prandaj kanë aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar AK që lënda të kthehet jo në ri-vlerësim siç kishte kërkuar OE ankues, por në **ri-tenderim** meqenëse janë evidentuar shkelje edhe gjatë hartimit të dosjes së tenderit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesë nga OE “Prompt International”, e cila ka pretenduar se **AK- PTK** ka bërë shkelje esenciale të nenit 60 dhe 69 të LPP-së lidhur me **tenderin “Furnizimi dhe Instalimi i Sistemeve për Klimatizim për Regjionin e Ferizajt, Mitrovicës, Gjakovës dhe Pejës** “ duke qenë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar produkte që nuk plotësojnë kriteret teknike të kërkuara në dosje të tenderit. Eksperti Shqyrtues ka rekomanduar që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Pas seancës dëgjimore, ku Paneli Shqyrtues ka shqyrtuar të gjitha provat dhe dëgjuar të gjitha palët ka konstatuar se AK nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, dhe prandaj ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik “Logistics Plus”L.L.C. ”- Prishtinë, si palë e pakënaqur gjatë fazës tenderuese ka deponuar ankesë në OSHP ndaj **AK-PTK** lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e GPRS-ve në mjetet motorike të PTK-së**”. OE ankues ka pretenduar se AK ka bërë shkelje të nenit 28 pika 2 dhe 7 të LPP-së gjatë vendosjes së kriteve. Eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP në raportin e tij ka konstatuar se ka shkelje të nenit 28 duke qenë se kriteret janë favorizuese për një brand të caktuar dhe nuk është përdor shprehja “ekuivalente”. Prandaj ai ka rekomanduar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim. Meqenëse AK nuk është pajtuar me këtë raport, PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe trajtuar të gjitha provat ka konstatuar se ka shkelje të nenit 28 dhe ka urdhëruar që tenderi të kthehet në **Ri-tenderim**.

Përveç vendimeve të cilat janë përshkruar më lartë në këtë kapitull të “Buletinit të Prokurimit” vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe OSHP ka shqyrtuar edhe dy lëndë të tjera të cilat përveç tjerave kanë qenë subjekt i “Konkluzionit” të vetë OSHP-së të datës 27 Mars 2014.

Kështu, aktiviteti i prokurimit **“Furnizim me Kemikale në TCA; Lot-1: hidroksid natrium (NaOH)”** të iniciuar nga AK- KEK i cili fillimisht është shpallur me datë 02 Gusht 2013, por pastaj pas kalimit në disa faza të ankesës ku së fundi eksperti shqyrtues kishte kërkuar Ri-vlerësim, rekomandim me të cilin nuk ishte pajtuar AK-KEK. Në këtë rast, në mungesë të një vendimi meritore për shkak të mos-funksionimit të OSHP-së në atë periudhë, vendimi për dhënie të kontratës OE “Ripten Engineering”SHpk është anuluar nga ana e vet AK me një vendim të datës 18 Mars 2014. Duke mos u pajtuar me këtë vendim OE në fjalë ka deponuar ankesë në OSHP me 27 Mars 2014 duke pretenduar se me këtë rast AK-KEK ka bërë shkelje të nenit 26 të LPP-së dhe ka kërkuar nga tashmë bordi funksional i OSHP-së anulimin e njoftimit për anulim të dhënies së kontratës dhe autorizim për procedim të nënshkrimit të kontratës. Paneli shqyrtues i OSHP ka pranuar që të shqyrtojë këtë lëndë dhe pasi ka trajtuar të gjitha provat dhe dëgjuar të gjitha palët në seancë dëgjimore ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues “Ripten Engineering”SHpk dhe ka anuluar vendimin e AK-KEK për anulimin e dhënies së kontratës dhe ka autorizuar procedimin me nënshkrim të kontratës.

Aktiviteti tjetër i prokurimit **“Ndërtimi i stacionit policor- faza e dytë-në Kllokotë”** i iniciuar nga AK- **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal** fillimisht është shpallur në Korrik të vitit 2013. Mirëpo më pas ky aktivitet është kthyer në Rivlerësim me vendim të OSHP-së dhe procedura e Ri-vlerësimit ka mbaruar me 29 Gusht 2013 ku nga ana e komisionit të vlerësimit është rekomanduar për shpërblim me kontratë OE “AstraPlan” sh.p.k. Lëvizja FOL ka monitoruar me pjesëmarrje direkte procedurën e rivlerësimit, me ç’rast disa herë ka tërhequr vërejtjen për neglizhencë të komisionit vlerësues dhe punë të ngadalshme, e që si të tillë këtë vërejtje e ka përkrahur edhe zyrtari kryesor i prokurimit. Megjithatë komisioni ka përfunduar procedurën e vlerësimit brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Mirëpo personi përgjegjës i prokurimit- zyrtari i prokurimit i AK-MAPL e ka anuluar vendimin e komisionit vlerësues, me arsyetimin se operatorëve ekonomik ofertues, më 25 Gusht 2013 iu ka skaduar afati i vlefshmërisë së ofertave, tri (3) ditë para se komisioni të nxjerr vendimin e vet.

AK- MAPL e ka ri-shpallur këtë tender me 26 Shkurt 2014, dhe me 21 Mars 2014 OE “AstraPlan” sh.p.k ka deponuar ankesë kundër njoftimit për kontratë në OSHP ku ka pretenduar se AK me këtë rast ka bërë shkelje të

një sërë nenesh të LPP-së. Ekspertja shqyrtuese e autorizuar nga OSHP ka konstatuar se të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues nuk ndërlidhen me njoftimin për kontratë të 26 Shkurtit 2014 por me aktivitetin e prokurimit të realizuar gjatë vitit 2013. Duke u bazuar në këtë fakt ajo ka rekomanduar Panelit Shqyrtues që ankesa të refuzohet si e pa-bazuar dhe t'i lejohet AK-së që të vazhdoj me procedurën e shpallur.

Gjatë seancës dëgjimore dhe pas dëgjimit të të gjitha palëve dhe trajtimit së të gjitha provave dhe duke pasur parasysh kronologjinë e ngjarjes, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK-MAPL nuk ka zbatuar vendimin e OSHP-së të 31 Korrikut 2013, gjithashtu nuk ka respektuar nenin 105 paragrafi 2 pikën 10 të LPP-së si dhe nenin 28 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, duke neglizhuar procesin e ri-vlerësimit të ofertave për tenderin në fjalë. Në këtë rast si pasojë ka ardhur deri te skadimi i vlefshmërisë së ofertave të OE që kanë tenderuar.

Kryetari i Panelit Shqyrtues e ka pyetur përfaqësuesen e AK-MAPL se a ka qenë e njoftuar me nenin 28 pika 4 të UOPP ku thuhet “*Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)”. Përfaqësuesja është përgjigjur se ka qenë e njoftuar me këtë nen, mirëpo komisioni e ka dorëzuar raportin në datën e lartë-cekur pas përfundimit të validitetit të ofertave.*

Në këtë rast Paneli Shqyrtues ka vendosur që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, t'i lejohet AK-MAPL të lejojë me procedimin e Njoftimit për Kontratë të datës 26 Shkurt 2014, mirëpo ka gjetur fajtor AK për skadimin e afatit të vlefshmërisë së ofertave dhe me këtë rast e ka dënua AK-në me 20,000.00 euro dhe zyrtarit kryesor për prokurim publik në MAPL i ka anuluar certifikatën e profesionalizmit për prokurim publik të lëshuar nga IKAP.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur - OSF dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile - CRD. Ky Raport është përgatitur nga stafi i Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti.

Ndërsa, të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org.

Për Lëvizjen FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.